

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall Data:15.06.2023

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale, për nevoja spitalore” Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALOR (CPV):Materiale mjekimi te konsumueshme 33140000-3

Fondi Limit:1,933,176 (Njëmilion e nëntëqind e tridhjetë e tremijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Spitali Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për te cilat oferton. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, teLigjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "PërTatiminmbitëArdhurat", I ndryshuar, kupërcaktohet: Çdotatimpaguespergatitdeklaratenvjetoreteteadhuravetetatuseshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e MinistritteFinancave ne zbatimteketijligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së lotit ku ofertohet / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurron.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne baze të VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës"

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001 /ose/ ekuivalent ISO 13485 "Per Sistemin e menaxhimin të cilesise" /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE

ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.

Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.4 Ofertuesi duhet te jete i certifikuar me ISO 9001 ose ekuivalente të vlefshme, për fushën e veprimtarisë që përfshin objekti i prokurimit.

Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose Certifikate FDA, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga kompania prodhuese /Distributor i Autorizuar per Shqiperine per kete procedure prokurimi per tregtimin e artikujve te ofruar.Ne rastin e distributorit te autorizuar per Shqiperine te provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. ”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmeshin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 2 “ *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistroheshin në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*” Si dhe ne baze të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 pika 5 a) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë/kuqe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e **kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqip)**

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;

2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar.

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Autoritetit Kontraktor, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “*Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit*”

- *Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2).*
- *Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2).*

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete*

elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Shënim për operatorët ekonomik:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në seksionin e specifikimeve teknike, *komisioni* vendosi të njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas shkresës për përllogaritjen e fondit limit të hartuar nga grupi i punës në përputhje me parashikimet e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Blerje materiale konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore

Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia	Sasia
	Materiale mjekimi për Anestezi - reanimacion			
1	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë	3.000
2	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë	3.000
3	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë	2.500
4	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë	6.000

5	Age spinale e zakonshme	26 G, L=7-9 cm	Copë	400
6	Age spinale atraumatike	Pencil point; 26 G; L=7-9cm	Copë	30
7	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë	2.000
8	Kateter urinar	2 rrugesh, 20 ch, balon 30-50 ml	Copë	150
9	Kateter urinar	2 rrugesh, 18 ch, balon 30-50 ml	Copë	150
	Shiringa, Age			
10	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë	50
11	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë	8.000
12	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë	25.000
13	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë	42.660
14	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë	20.000
15	Age 18G	sterile	Copë	700
16	Age 20G	sterile	Copë	500
17	Age 21G	sterile	Copë	500
	Materiale nje perdorimeshe per kirurgji			
18	Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm	Cope e thurur, me thithje te shpejte per plage, me perberes polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent	Copë	5

19	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashes qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent	Copë	5
	Materiale qepes kirurgjikale Sutura mendafshi			
20	Silk -USP 1, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	500
21	Silk -USP 0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	500
22	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë	300
23	Silk -USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese	Copë	100
24	Silk -USP4-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë	100
	Sutura Sintetike te Absorbueshme			
25	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioi i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	1.000
26	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioi i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë	1.000
27	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioi i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë	300
28	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioi i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë	500

29	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë	500
	Dezifektante Mjekesore dhe Kirurgjikale			
30	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët per desinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshem për ta përdorur	litra	25
31	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të te plageve te jashtëme , i gatshëm për ta përdorur	litra	50
32	Formaldehid	Solucion 35-40%	litra	5
33	Benzalchonium chloride 10%	Benzalconium chloride 10%. Per dezinfektimin dhe pastrimin e siperfaqeve. Efekt baktericid, mycobaktericid, antiviral.	litra	3

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimete teknike te pergjithshme

Materialet e mjekimit duhet të përmbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.

Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njësia referuar relacionit të përlogaritjes së fondit limit përcaktoi kohëzgjatjen si më poshtë:

-Afati i marrëveshjes kuadër 12 muaj.

KOMISIONI

- Astrit Haskurti Person pergjegjes
- Dorina Poçi Ekonomiste
- Ardian Bashllari Jurist

MIRATOI

DREJTORI
Bledar HIMA